



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-300/01-16009 të datës 30.03.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës Help –Hilfe zur Selbsthilfe e.V, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.06.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE ORGANIZATËS "HELP"

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **19.200.00 €** (nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind euro), konform Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-300/01-16009 të datës 30.03.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës Help –Hilfe zur Selbsthilfe e.V.

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-300/01-16009 të datës 30.03.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës Help –Hilfe zur Selbsthilfe e.V. me qëllim të realizimit të projektit të përbashkët me titull "Përfshirja dhe Fuqizimi Ekonomik në Ballkanin Përendimor" i financuar nga Qeveria gjermane dhe zbatuar nga Help ku Komuna e Lipjanit obligohet të participojë me shumën e mjeteve financiare si në pikën I të këtij Vendimi.

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikura për vitin 2023 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, kodi i programit 47003, fondi burimor 21/613/47003/200/00000/0421.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-400/01-33617

Lipjan, më 30.06.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

